

RELACION TEKNIK

(PROJEKT ME PERSHKRIM)

Mirëmbajtje me performancë :Berat –Corovode,Corovode –Hambull,Hambull-Rog (62.7km) (Kontrata 10)

1. Qëllimi i Shërbimeve që do kryhen

Shërbimet që do mundësohen përfshijnë gjithë veprimtaritë, fizike dhe të tjera, që duhet të kryhen, sipas përputhshmërisë së tyre me Nivelet e Shërbimit dhe kriterin e caktuar të realizimit të tyre të performancës, apo me çdo kërkesë tjetër.

Në vecanti, ato përfshijnë detyrat menaxheriale dhe punimet fizike që lidhen me asetet dhe zërat që lidhen me rrugën:

- Asfaltimet
- Bankinat
- Sinjalistika dhe furnizimi pajisjet për sigurinë rrugore
- Strukturat e drenazhimit
- Kontrolli i vegjetacionit
- Skarpatat (gërmimet dhe bankinat)
- Veprat e artit
- Menaxhimi i trafikut
- Grumbullimi i dherave
- Pastrimi i dëborës (nqs ka mirëmbajtje dimërore)

Shërbimet që kërkon Mirëmbajtja e një rruge klasifikohen në:

2. Punimet Rehabilituese/periodike, në formën e sasisë së një vlere tavan, ndërsa tregohen sasi të punimeve të matëshme që do kryhen në mënyrë që rruga të arrijë Standardet e asaj performancë.
3. Shërbimet e Mirëmbajtjes Rutinë në formën e sasisë së shprehur në një vlerë tavan mujore (kjo do jetë një sasi mujore e aplikueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së shprehur në çmim për kilometër për secilin muaj e shumëzuar me gjatësinë e rrugës dhe kohëzgjatjen e shërbimeve);
4. Punimet Emergjente në formën e një preventivi tradicional.

Funksionet kryesore të bazave të mirëmbajtjes në përgjithësi, duhet të jenë si më poshtë:

1. Mbikëqyrja e segmentit/seksionit rrugor në periudha të caktuara sipas niveleve të shërbimit
2. Kontrolli i të dhënave të trafikut për këtë segment
3. Vëzhgimi i faktorëve meteorologjikë
4. Ndihma e parë në rast aksidenti (në lidhje me elementët e rrugës dhe trafikut)
5. Mirëmbajtje në kushtet e dëshiruara të shtresave rrugore
6. Mirëmbajtja e hapësirave të parkimit, shërbimit, shenjave rrugore, sistemeve të ndriçimit, sinjalizimit të ardhshëm e telekomunikacionit.
7. Riparime dhe rindërtim pas aksidenteve rrugore
8. Riparime dhe rindërtim pas fatkeqësive natyrore
9. Operacionet e pastrimit të drenazheve, tombinove dhe objekteve të tjera që lidhen me largimin e ujrave nga sipërfaqja e rrugës
10. Të gjithë operacionet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e :
 - shenjave rrugore, pajisjeve të sigurisë (gardhe, parapet) sistemi i ndricimit.

- riparimi lokal i dëmtimeve të trotuarit
- kujdesi për bimesinë
- aktiviteti në dimer për largimin e dëborës dhe akullit.

Punimet e mirëmbajtjes në kushtet dimërore, përfshijnë:

1. Punime paraprake para fillimit të kushteve të dimrit
2. Organizimi i vendodhjeve të depozitimit të materialeve
3. Masat mbrojtëse për borën, akullin, grumbujt e borës dhe ortekët
4. Pastrimi i dëborës nga karrexhata e autostrades dhe sinjalet e komunikacionit dhe shenjat
5. Shenjimi i anëve të karrexhatës
6. Sigurimi i funksionimit të drenazhimit nga karrexhata
7. Heqjen e automjeteve nga rruga
8. Instalimi i sinjaleve të vecanta të komunikacionit në rastet e rregjimit të trafikut të veçantë të mbylljes së rrugës.
9. Informimi i vazhdueshëm i publikut për gjëndjen e rrugës dhe rrjedhën e trafikut.

5. Segmentet që mbulon kontrata

Nr. Rrugës	Nr. Rendor	Emërtimi i Rrugëve	Tipi rrugës	Gjatësia totale (km)	Gjerësia (m)
72	1	Berat - Corovode	SHL	45.7	6
ska	2	Corovode - Hambull	SMTW	12.7	5
ska	3	Hambull - Rog	SMTW	4.3	5
SHUMA KONTRATA 10				62.7	

Shënim: SFL – rrugë në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, SHL – rrugë në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, SMTW – rrugë në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.

6. Kusht i veçantë

Për çdo rast, nga kontrata do të zbriten segmente të saj nqs do të përfshihen në investim (rikonstruktion) apo projekte të tjera të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

7. Sinjalistika dhe siguria rrugore

Mirëmbajtja e sinjalistikës dhe siguria rrugore (barrierat) do të fokusohet tek riparimi dhe rifreskimi e asaj ekzistuese.

8. Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga

Rruga:Berat-Corovode me gjatesi 45.7km

Aksi rrugor Berat-Corovode kalon ne nje terren kryesisht kodrinor-malor ne pjesen Jug Lindore te rrethit te Beratit dhe ne pjesen Perendimore te rrethit Skrapar.

Aksi rrugor Berat-Corovode fillon ne dalje Uznove (ne veri te Lokal “Avatar” dhe perfundon ne sheshin e qendres se qytetit Corovode(Para godines se Bashkise).

Ky aks rrugor qe fillon ne dalje te lagjes Uznove me pas kalon ne disa fshatra te rrethit Berat si Vodice,Fushe Peshtan,Vertop,Mbrakull , Plirez(Ura e Plirezes) e cila eshte dhe kufiri ndares midis rretheve Berat dhe Skrapar) dhe vazhdon ne rrethin e Skraparit se pari me qytetin e Policanit dhe me pas me fshatrat Pronovik,Bogove,Kakruke,Orizaj,Munushtir dhe se fundi ne qytetin e Corovodes .

Aks rrugor Berat-Corovode sherben si nje lidhese midis dy rretheve dhe i sherben nje komuniteti te madh i cili ndodhet ne keto zona si dhe biznesit.

Pershkrimi e aksit rrugor Berat-Corovode 45,7km.

Aks rrugor Berat-Corovode me gjatesi 45,7km eshte ne pergjithesi ne gjendje te mire ,me perjashtim te amortizimeve ne segmentin rrugor Hyrje Bogove –Orizaj(km33-km40) .

-Eshte aks rrugor me nje karexhate dhe me dy kahe levizjeje.

-Shtresat rrugore Pjesa e rruges Berat –Polican ka nje shtrese asfaltike ne gjendje te mire,pasi eshte permisuar ndjeshem ne vitin 2019 nga nje donacion i TAP. Ndersa segmenti Hyrje Bogove –Kakruke-Orizaj i kesaj rruge eshte i amortizuar .Ky amortizim lidhet me mungese te investimeve dhe per shkak dhe te terrenit te veshtire , pranise se burimeve te ujit dhe ngricave ku kalon ky segment rrugor.Ne kete zona rreth 30% te gjatesise se segmentit eshte e amortizuar. Ky amortizim ka shkaktuar dhe gropezime te permasave te mesme dhe te medha te kesaj rruge si dhe disa cedime.

Ndersa segmenti i kesaj rruge K/Buzuq –Ura Munushtir-Qender Corovode eshte nje gjurme e re rruge e ndertuar rreth 3vjet me pare dhe gjendja aktuale e tij paraqitet pa probleme.

-Kanalet anesore .Terreni kodrinor –malor ne te cilin kalon rruga ne disa zona krijon gjithmone rreshqitje dherash,aluvione,renie guresh dhe masivesh.Me problematike jane zona e Bogoves,Shkambi Selanit,Hija e Kakrukës,Ripi Strokes.Ne kushtet kur rruga kalon ne kufi me terrenin malor dhe me burime uji dhe kanalet anesor mbushen vazhdimisht.

-Bankinat jane me permasa minimale ne te gjitha gjatesine e rruges,per aresye te njetjta te pershkruara me siper duhen mirembajtur ne menyre periodike.


-Bimesia eshte prezente pothuajse ne gjitha gjatesine e rruges.Eshte e llojit shkurre dhe pisha.Keto te fundit rrezikojne rrugen pasi ndodhen shume prane saj ne km 25-km40.

-Sinjalistika .Rruga eshte e pajisur me tabela me shenja rrugore normale dhe treguese dhe ne periudhen Prill-Maj 2020 eshte realizuar nje investim nga Arsh-ja per sinjalistiken .Eshte e nevojshme vendosja e pervijuesve ne te gjitha gjatesine e rruges .Vijeimet horizontale jane te dukshme.Guardrailet jane ne gjendje te mire,por sasia e tyre duhet te shtohet ne zonen e Bogoves.

-Vepra arti .Rruga ka shume vepra arti te llojeve ura betonarme,tombino rrethore dhe katrore,mure mbajtes dhe prites.Ne pergjithesi keto vepra arti jane ne gjendje te mire pa problematike ne strukture.

-Trafiku .Ne kete rruge ka nje trafik te dendur te mjeteve per transport publik ,mallra dhe te tonazheve te renda.

HARTA E VENDODHJES SE AKSIT RRUGOR BERAT-COROVODE 45,7KM



Rruga:Corovode-Hambull me gjatesi 12.7km

Aksi rrugor Corovode –Hambull shtrihet ne nje terren kodrinor – malor me parametra planimetrike te disfavorshem. Rruga shtrihet ne terren me kthesa te forta dhe te vazhdueshme. Shume niveleta te rruges paraqiten me pjerrresi te madhe. Rruga kalon ne zonen e kanioneve dhe nderpritet me disa perrenj e rrjedha ujore te rrembyeshme dhe nga lumi „Osum,„. Prania e bores dhe akullit eshte prezente ne kete aks gjate stines se dimerit.Per kete aks eshte planifikuar dhe mirembajtje dimerore.

Zona ne te cilen aksi kalon eshte nje zone kryesisht e banuar dhe ky aks lidh zonen e Skraparit me zonen e Permetit dhe me doganen e Tre Urave. Nga pikpamja social – ekonomike paraqitet me rendesi te vecante pasi lidh shume qendra te banuara, i sherben nje komuniteti te madh dhe biznesit.

Pershkrimi e aksit rrugor Corovode –Hambull 12,7km.

-Eshte aks rrugor me nje karexhate dhe me dy kahe levizjeje.

-Shtresat rrugore aktualisht jane te shtruara me asfalt dhe ne gjendje te mire. Gjithashtu ka dhe nje pjese rruge me trotuare anesore me shtrese pllake betoni dekorative te cilet jane ne gjendje te mire.

-Kanalet anesore .Terreni i thyer dhe malor ne te cilin kalon rruga krijon gjithmone rreshqitje dherash,aluvione dhe renie guresh,si rrjedhim mbushja e kanaleve anesore eshte shume e shpejte.

-Kunetat anesore.Pjesa e rruges me trotuare dhe mure prites eshte me kunete betoni.Kunetat aktualisht jane ne gjendje te mire.Per aresye te terrenit te thyer pastrimi i tyre duhet i vazhdueshem.

-Bankinat jane me permasa minimale ne te gjitha gjatesine e rruges. Aktualisht jane ne gjendje te mire.


-Bimesia eshte prezente ne te gjitha gjatesine e rruges.Eshte e llojit shkurre dhe pisha.Keto te fundit rrezikojne rrugen pasi ndodhen shume prane saj.Kontrollet periodike te rruges duhen bere ne menyre te eliminohen rreziqet e rruges nga renia e pishave.

-Sinjalistika .Rruga eshte e pajisur me tabela vertikale me shenja normale dhe treguese.Eshte e pranishme elementi guardrale ne disa pjese te rruges.Aktualisht ky element eshte i pademtuar.Eshte e nevojshme vendosja e pervijuesve ne te gjitha gjatesine e rruges.Vijeizimet e rruges jane te dukshme por jo fosforeshente.

-Vepra arti .Rruga ka volume te konsiderueshme mure prites dhe mbajtese me strukture beton arme,tombino dhe ura betoni Ne pergjithesi keto vepra arti jane ne gjendje te mire.

-Trafiku .Ne kete rruge ka nje trafik ne nivel mesatar kryesisht te mjeteve te transportit publik dhe mallrave.Kalojne dhe mjete te tonazheve te renda.

HARTA E VENDODHJES SE AKSIT RRUGOR COROVODE –HAMBULL 12,7KM



Rruga:Hambull -Rog me gjatesi 4.3km

Aksi rrugor Hambull-Rog shtrihet ne nje terren kodrinor – malor me parametra planimetrike te disfavorshem. Rruga shtrihet ne terren me kthesa te forta dhe te vazhdueshme. Shume niveleta te rruges paraqiten me pjerrresi te madhe. Rruga kalon ne zonen mbas kanioneve dhe anes shpatit te nje lugine. Prania e bores dhe akullit eshte prezente ne kete aks gjate stines se dimerit.Per kete aks duhet planifikuar dhe mirembajtje dimerore.

Zona ne te cilen aksi kalon eshte nje zone kryesisht e banuar dhe ky aks lidh zonen e Skraparit me zonen e Permetit dhe me doganen e Tre Urave. Nga pikepamja social – ekonomike paraqitet me rendesi te vecante pasi lidh shume qendra te banuara, i sherben nje komuniteti te madh dhe biznesit.

Pershkrimi e aksit rrugor Hambull-Rog 4,3km.

Ky aks rrugor eshte nje gjurme e re rruge e ndertuar rreth viteve 2018 me investim te Buxhetit te Shtetit.Ndertimi i ketij aksi perfundoi ne maj te vitit 2019 , i cili eshte loti i dyte i rruges Corovode –Permet dhe deri ne 08 Maj 2021 eshte ne periudhe garancie .

-Eshte aks rrugor me nje karexhate dhe me dy kahe levizjeje.

-Shtresat rrugore aktualisht jane te shtruara me asfalt dhe ne gjendje te mire.

-Kanalet anesore .Terreni i thyer dhe malor ne te cilin kalon rruga krijon gjithmone rreshqitje dherash,aluvione dhe renie guresh,si rrjedhim mbushja e kanaleve anesore eshte shume e shpejte.

-Kunetat anesore.Pjesa e rruges me trotuare dhe mure prites eshte me kunete betoni.Kunetat aktualisht jane ne gjendje te mire.Per aresye te terrenit te thyer pastrimi i tyre duhet i vazhdueshem.

-Bankinat jane me permasa minimale ne te gjitha gjatesine e rruges. Aktualisht jane ne gjendje te mire.

-Bimesia eshte prezente ne te gjitha gjatesine e rruges.Eshte e llojit shkurre dhe pisha.Keto te fundit rrezikojne rrugen pasi ndodhen shume prane saj.Kontrollet periodike te rruges duhen bere ne menyre te eliminohen rreziqet e rruges nga renia e pishave.

-Sinjalistika .Rruga eshte e pajisur me tabela vertikale me shenja normale dhe treguese.Eshte e pranishme elementi guardrale ne disa pjese te rruges.Aktualisht ky element eshte i pademtuar.Eshte e nevojshme vendosja e pervijuesve ne te gjitha gjatesine e rruges.Vijezimet e rruges jane te dukshme por jo fosforeshente.

-Vepra arti .Rruga ka volume te konsiderueshme mure prites dhe mbajtese me strukture beton arme,tombino dhe ura betoni Ne pergjithesi keto vepra arti jane ne gjendje te mire.

-Trafiku .Ne kete rruge ka nje trafik ne nivel mesatar kryesisht te mjeteve te transportit publik dhe mallrave.Kalojne dhe mjete te tonazheve te renda.

HARTA E VENDODHJES SE AKSIT RRUGOR HAMBULL-ROG 4,3KM

